

BIBLIOTEKA
KOMBËTARE
DHE UNIVERSITARE
E KOSOVËS



THE NATIONAL
AND UNIVERSITY
LIBRARY
OF KOSOVA

Konsorciumi i Bibliotekave Elektronike të Kosovës



Informacione Elektronike për Biblioteka



Instituti për Shoqëri të Hapur



Konsorciumi i Bibliotekave Elektronike të Kosovës



Informacione Elektronike për Biblioteka



Instituti për Shoqëri të Hapur

Botues: Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

Kryeredaktor: Dr. Sali Bashota

Përzgjedhja: Mr. Shukrie Rama

Përkthimi: Besim Kokollari

Realizimi kompjuterik: Hekuran Rexhepi

Shtypi: Shtypshkronja Prograf
Prishtinë 2004

Sponsor i botimit:



Institutit për Shoqëri të Hapur

Përmbajtja

Informacione Elektronike për Biblioteka	5
Kur filloi eIFL?	5
Roli i konsorciumeve bibliotekare të eIFL	7
Parimet udhëheqëse të eIFL.net	8
Objektivat e eIFL.net	8
Anëtarët e eIFL.net	8
Çfarë u ofron eIFL.net anëtarëve të saj	9
Shërbimet e eIFL	9
eIFL Direct	10
Modelet e Licencave	11
Trajnimet dhe takimet e punës	13
Shfrytëzimi i përbashkët i dijes dhe informacionit	14
Udhëzime	14

Informacione elektronike për biblioteka

eIFL.net është fondacion i pavarur, që synon të udhëheqë, negociojë, mbështesë dhe përkrahë përdorimin e gjerë të burimeve elektronike nga përdoruesit e bibliotekave të vendeve në transicion dhe zhvillim. Objektivi i saj kryesor është negociimi për abonim të përbalueshëm në burimet elektronike të të gjitha vendeve anëtare të konsorciumit, duke mbështetur në të njëjtën kohë zgjerimin dhe krijimin e konsorciumeve lokale të bibliotekave të vendeve anëtare.

Kur filloi eIFL?

eIFL veprimtarinë e saj e filloi në tetor të vitit 1999, si një iniciativë e Institutit për Shoqëri të Hapur (OSI), një fondacion privat, i cili merret me donacione dhe veprimtari të tjera e që është pjesë e Rrjetit të Fondacionit Soros. Në vitet '90, OSI investoi mjaft shumë për zhvillimin dhe modernizimin e bibliotekave në vendet në të cilat e kishte të shtrirë rrjetin e saj, e posaçërisht në vendet post-socialiste të Evropës Qendrore dhe Jug-lindore e poashtu edhe të ish-vendeve të Bashkimit Sovjetik.

Këto vende tradicionalisht kishin një sistem të përsosur të arsimit, dhe pa dyshim që paraqitnin një treg të ri për agjentët ndërkombëtarë të ofrimit të informacionit arsimor. Megjithatë, çmimi i lartë i abonimit dhe dituria relativisht e ulët për të pasur mundësi të abonimit në burimet elektronike, krahas atyre të shtypura, i mbante këto vende të privuara nga pasuria e revistave akademike dhe e bazave të të dhënave ndërkombëtare.

Në përpjekjet e saj për ta mbështetur arsimin dhe hulumtimet e karakterit studiuës të vendeve në transicion, OSI (Instituti për Shoqëri të Hapur) ka për qëllim t'u ndihmojë bibliotekave dhe përdoruesve të tyre të kenë mundësi të shfrytëzimit të burimeve elektronike me një çmim sa më të përshtatshëm.

Pasi qasja në burimet digjitale të internetit mund të negociohet deri në një çmim të levërdishëm me ofruesin e atyre burimeve, ideja

ishte për ta nivelizuar fuqinë blerëse të konsumatorëve individualë të vendeve në transicion dhe të negociohej me ofruesin e informacioneve si një konsorcium që përfaqësonte shumë vende dhe që do të siguronte qasje në këto informacione me një zbritje të madhe të çmimit.

Me këtë model, OSI përpiqej që të gjente një zgjidhje jo vetëm mes ndarjes që ekzistonte ndërmjet burimeve digjitale të Perëndimit dhe Lindjes, por kishte për qëllim të siguronte qasje të këtyre burimeve brenda secilit vend veç e veç, po ashtu, duke përfshirë institucionet me fonde të mjaftueshme, por edhe bibliotekat më të vogla, të cilat nuk posedonin fonde të mjaftueshme për pasurim me koleksione të reja.

Zgjedhja e parë e botuesve dhe agentëve bashkëpunëtorë u bë në saje të dy tenderëve të hapur për publikun, të publikuara në prill të vitit 1999 dhe korrik të vitit 2001. Në tenderin e parë kërkoheshin revistat dhe bazat e të dhënave në shkencat shoqërore dhe humanitare, ndërsa në të dytin, për ato të shkencave dhe teknologjisë.

Në të dy propozimet kërkoheshin çmimet për ofrimin e modelit elektronik të burimeve, me theks të veçantë në materialet me tekst të plotë. Për këtë nismë, në favor të shumë vendeve ishte përvetësuar edhe modeli i licencës në bazë kombëtare: për çmimin që do ta bartte një vend, mund të regjistroheshin një numër i pakufizuar i bibliotekave për të pasur qasje në burimet e abonuar si dhe një numër i pakufizuar i përdoruesve mund t'i shfrytëzonin ato shërbime në të njëjtën kohë.

Në vitin 2002, eIFL u bë fondacion i pavarur. Ky fondacion pjesërisht financohet nga OSI dhe tani për tani është në kërkim të partnerëve, të cilët do ta mbështesin me fonde. Fondacioni i ri eIFL do të veprojë si agjent ku do të marrin pjesë konsorciumet kombëtare. Përveç kësaj, ajo, me të ardhurat të cilat do të krijohen nga anëtarësimi, do të ofrojë trajnime, konsultime dhe një varg shërbimesh të tjera.

Roli i konsorciumeve bibliotekare të eIFL

Gjatë viteve të para të projekteve, personeli vendor i Fondacionit Soros, së bashku me udhëheqjen e ekipit koordinues të eIFL në Budapest, ishin të ngarkuara me administrimin dhe gjetjen e fondeve per abonim. Kjo mënyrë e menaxhimit të sipërpërmendur justifikohet me:

- mungesën e përvojës së vendeve pjesëmarrëse në Soros në shfrytëzimin e burimeve elektronike;
- nevojën për përpjekje të koordinuara dhe efikase në implementimin e nismave me qëllime inovacionesh.

Megjithatë, mbështetja afatgjate e projektit kërkonte edhe një përfshirje më aktive të bibliotekave lokale në koordinimin e sigurimit të informacionit, promovimit, trajnimit, gjetjes së fondeve dhe pagesave për eIFL.

Për arsye se është e bazuar në një model të gjerë të konsorciumeve, u bë e qartë se ekzistimi dhe themelimi i konsorciumeve të bibliotekave lokale mund ta marr këtë rol. Që nga viti 2001 eIFL është përqendruar në çështje të reja: mbështetja e formimit të konsorciumeve lokale të bibliotekave në vendet anëtare me qëllim të sigurimit të vazhdueshëm të qasjes dhe të shfrytëzimit sa më efikas të burimeve të ofruara elektronike.

Përpjekje të reja u bënë në këshillimin e anëtarëve sa u përket çështjeve që kanë të bëjnë me konsorciumin përmes sigurimit të resurseve të dobishme dhe organizimit të takimeve dhe trajnimeve. Në vitin 2002, eIFL e përpiloi një skemë granti për themelimin e konsorciumeve. Fondet e marra nga eIFL mund të shfrytëzohen për mbulimin e shpenzimeve të konsorciumit dhe po ashtu për shpenzimet për veprimtarinë e tij për vitin e parë, përfshirë shpenzimet e zyrës, personelit shtesë, takimeve, pjesëmarrjen në konferenca si dhe vizitat në konsorciume të suksesshme në biblioteka të tjera.

Parimet udhëheqëse të eIFL.net

Parimet kryesore, të cilat u japin shtytje aktiviteteve të eIFL.net, mund të përmbledhen si më poshtë:

- qasja në informacione është thelbësore në arsimim dhe në studime dhe se ka ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin e shoqërive;
- fuqia e përbashkët blerëse dhe negociuese e bibliotekave mund të shpiejë në sigurimin e burimeve elektronike të informacionit për një periudhë më të gjatë dhe me një çmim më të përballueshëm nga vendet në transicion;
- pajisja e qytetarëve me njohuri dhe përhapja e demokracisë varet në të pasurit qasje të barabartë në burimet e informacionit në mbarë botën: eIFL është e vendosur ta luajë këtë rol.

Objektivat e eIFL.net

Bashkimin e fuqive blerëse të një numri të madh të bibliotekave, duke i përfaqësuar ato dhe konsorciumet e tyre para shitësve dhe prodhuesve të informacionit, para vendim-marrësve dhe atyre që u ndajnë fonde, janë ndër objektivat kryesore të eIFL.net.

Përveç kësaj, eIFL.net synon:

- të zgjerojë llojllojshmërinë e produkteve të ofruara;
- të bëjë një laramani modelesh të shpërndarjes dhe të fondeve me qëllim të përmbushjes së kërkesave sa më të llojllojshme;
- të rrisë numrin e vendeve anëtare;
- të sigurojë njohuri dhe burime të përbashkëta për anëtarët e saj.

Anëtarët e eIFL.net

Anëtarë të eIFL.net janë konsorciumet e bibliotekave lokale, të cilat e bartin përgjegjësinë e sigurimit të licencës kombëtare të burimeve elektronike. Struktura, anëtarësia dhe financimi i këtyre konsorciumeve ndryshon nga vendi në vend. Disa prej tyre kanë

një status zyrtar dhe ofrojnë një varg shërbimesh, e disa prej tyre janë jozyrtare ku bibliotekat janë bashkuar me të vetmin qëllim që të kenë një licencë të përbashkët të revistave elektronike.

Në disa raste, Biblioteka Kombëtare është konsorciumi zyrtar apo edhe jozyrtar që ka rolin udhëheqës, e ndër të tjera ekziston një zyrë e veçantë që merret me udhëheqjen e konsorciumit. Vetem ca prej konsorciumeve financohen nga qeveritë në bazë të procedurave zyrtare të aplikimit, por në të shumtën e rasteve financimi mbulohet nga të ardhurat që mbledhen nga anëtarësimi i bibliotekave.

Nga aspekti gjeografik, eIFL.net filloi në vendet në të cilat vepronte rrjeti i fondacionit Soros. Megjithatë, në përgjigje të shumë kërkesave të vendeve në zhvillim nga e mbarë bota, filloi një zgjerim i saj në shumë vende të reja në vitin 2002. Përzgjedhja e vendeve të reja për t'u përfshirë në këtë rrjet bëhet në baza individuale, ku hapi i parë në këtë drejtim është identifikimi i një organi të duhur (konsorciumi, shoqate të bibliotekave apo Biblioteke Kombëtare) i cili do të mund t'i përgatiste të gjitha bibliotekat në shkallë kombëtare të kenë qasje në revistat elektronike.

Sot eIFL.net përfshin mëse 2200 biblioteka nga më shumë se 40 vende, me një numër të përgjithshëm të popullsisë afro 80 milionë.

Çfarë u ofron eIFL.net anëtarëve të saj

Shërbimi kryesor i eIFL.net është sigurimi i qasjes në revistat dhe bazat e të dhënave komerciale elektronike. Duke ia shtuar këtij shërbimi, eIFL.net ofron edhe një numër shërbimesh shtesë, përfshirë vlerësimin e nevojës së informacionit, modele dhe udhëzime për licenca, trajnime dhe takime pune, sigurimin dhe përdorimin e përbashkët të njohurive dhe të informacioneve, etj.

Shërbimet e eIFL

Shërbimi kryesor i eIFL.net është sigurimi i qasjes në revistat dhe bazat e të dhënave komerciale elektronike, përmes bërjes së nego-

ciatave të përbashkëta me botuesit dhe agjentët, të cilët merren me shitjen e tyre.

Përveç këtij shërbimi bazë, eIFL.net organizon një varg aktivitete, të cilat kanë për synim t'u sigurojnë anëtarëve të saj mbështetje, këshilla dhe trajnime në fushën e ndërtimit dhe të menaxhimit të konsorciumeve, integritit, menaxhimit dhe vlerësimit të burimeve elektronike, të marrjes të së drejtës autoriale dhe të licencës, marketingut dhe promovimit të shërbimeve të konsorciumeve, etj.

Shërbimet e tanishme të eIFL.net përfshijnë:

- [*eIFL Direct*](#)
- [*eIFL Science and Technology*](#)
- [*Social Science & Humanities*](#)
- [*eIFL Russian Content*](#)
- [*Provision of model license for e-resources*](#)
- [*Development of guidelines and technical guides on various aspects of managing library consortia*](#)
- [*Training and workshops*](#)
- [*Knowledge and information sharing*](#)
- [*Grants for consortia building and development*](#)
- [*Free journals*](#)

eIFL Direct

Më 1 Shtator të vitit 1999 [Open Society Institute – Budapest \(OSI\)](#) dhe [EBSCO Publishing](#) u morën vesh që të bashkëpunojnë në një projekt për ta krijuar konsorciumin më të madh të informacionit në botë.

Projekti u quajt *Electronic Information for Libraries Direct*, ose *eIFL Direct*, qëllim kryesor i të cilit ishte që t'u siguronte informacione elektronike bibliotekave (akademike, hulumtuuese, mjekësore, publike, kombëtare e parlamentare), ministrive dhe organizatave

joqeveritare. Përdoruesit e tyre mund të ishin dijetarë, vendimarrës, zyrtarë të qeverisë, studentë dhe publiku në përgjithësi i vendeve në transicion, të cilët vetëm për shkak të çmimit për të abonuar në revistat elektronike nuk kishin pasur qasje në këto burime të informacionit më parë.

Duke iu falënderuar eIFL Direct, vendet pjesëmarrëse kishin mundësi të abononin në këto informacione më një çmim shumë të ulët, duke iu siguruar qasje tërë komunitetit të tyre në shkallë vendi. Kostoja fillestare ishte garantuar për tri vjetët e para.

Trajnimet e ofruara nga trajnerët e EBSCO-s ishin elementi kryesor në implementimin e suksesshëm të projektit në vendet në të cilat bibliotekarët nuk kishin pasur përvojë të mëhershme në përdorimin e burimeve elektronike.

Sot mbi 2000 institucione bëjnë pjesë në këtë projekt dhe numri i tyre është në rritje të vazhdueshme. Për ta përcaktuar më mirë, mbi katër milionë kërkime janë kryer benda bazave të të dhënave të EBSCO-së dhe ky numër është në rritje e sipër për çdo ditë. Në ato vende në të cilat lidhja me internet kushton shumë ose nuk është e sigurt, bibliotekat i shfrytëzojnë të dhënat në formatin CD dhe DVD.

Modelet e Licencave

Licencimi i revistave elektronike nga ofruesit ndërkombëtarë është një praktikë krejtësisht e re në vendet në transicion dhe në zhvillim, dhe përkthimi i dokumenteve të natyrës ligjore, përshtatja e kontratave perëndimore për t'u përrputhur me nevojat vendore ishin një mundim shtesë për bibliotekarët dhe udhëheqësit e konsorciumeve.

Projekti i eIFL ka paraqitur një kontratë model dhe një licencë model që do të përdoret në lidhje me marrëveshjet e negociuara nga eIFL.net me secilin botues veç e veç.

Kontrata model përdoret për të konfirmuar marrëveshjen e negociuar ndërmjet eIFL.net dhe botuesit të caktuar. Programi 1 i çdo kontrate të eIFL.net me botuesit do të shënojë edhe çmimin e negociuar për secilin vend, i cili bën pjesë në projektin e eIFL.net. Varet

krejtësisht nga secili vend veç e veç nëse dëshirojnë ta pranojnë ose jo.

Licenca model paraqet mënyrat dhe kushtet e qasjes dhe shfrytëzimit të burimeve elektronike nga vendet pjesëmarrëse në eIFL. Licenca model do t'i dërgohet botuesit për t'u miratuar që në fillim të procesit të negocimit. Në qoftë se botuesi dëshiron të propozojë ndreqje të amandamenteve, eIFL.net do t'i vlerësojë ato amandamente dhe ato amandamente të rishqyrtuara do të përfshihen në licencën për ato burime të caktuara.

Licenca, e cila përdoret me ndonjë burim të caktuar mund të gjendet në Programin 2 të kontratës ndërmjet eIFL.net dhe botuesit në fjalë. Me fjalë të tjera, licenca që do të përdoret për qasjen dhe shfrytëzimin e bazave të dhënave të ProQuest quhet licenca e bazave të dhënave ProQuest dhe mund të gjendet në Programin 4 të kontratës ndërmjet eIFL.net dhe ProQuest.

Palët kontraktuese për licencë janë botuesi dhe një institucion. Institucioni mund të nënshkruajë:

- në mbështetje të vetë institucionit;
- në mbështetje të vetë institucionit por me licenca shtesë për t'u mundësuar
- qasje dhe për t'i shfrytëzuar burimet e caktuara edhe institucionet e tjera, të cilat i përfaqëson institucioni në fjalë;
- në favor të konsorciumit.

Për ta lehtësuar tërë këtë punë, projekti eIFL ka bërë dy forma të ndryshme të modeleve të licencave. Këto janë licenca botues – institucione individuale dhe licenca botues – konsorcium plus konsorcium – institucion me licenca shtesë.

Ekzistojnë licenca botues – institucione individuale, të cilat janë falas për vende të liruara nga pagesa si dhe licenca botues – konsorcium plus konsorcium – institucion me licenca shtesë falas për vende të liruara nga pagesa.

Trajnimet dhe takimet e punës

Aktivitetet e eIFL përfshijnë në mënyrë të denjë edhe aspektin e aftësisht, pasi që zhvillimi i shpejtë në fushën e informacioneve elektronike sjell me vete edhe praktika të reja, të cilat kërkojnë shkathtësi të reja nga bibliotekarët në transicion dhe vendeve në zhvillim. eIFL përpiket t'i integrojë anëtarët e saj në të gjitha forumet relevante ndërkombëtare.

Mbështetja për të marrë pjesë në konferenca nga koordinatoret e eIFL është bërë që prej fillimit me një theks të veçantë në ngjarjet ndërkombëtare që kanë të bëjnë me konsorciumet bibliotekare. Kjo u ka ndihmuar përfaqësuesve të vendeve të eIFL të mësojnë më shumë për çështjet dhe zgjidhjet lidhur me licensimet dhe shfrytëzimin e përbashkët të burimeve elektronike.

EIFL, po ashtu, i ka organizuar edhe ngjarjet e veta për vendet anëtare të eIFL. Koordinatorët kombëtarë dhe përfaqësuesit e bibliotekave janë mbledhur së bashku në takimet rajonale të punës së eIFL dhe në takimet e koordinatoreve kombëtarë të quajtura Asambleja e përgjithshme e eIFL. Këto ngjarje kanë qëllim të dyfishtë: aktivitetet dhe zhvillimet e eIFL janë diskutuar gjatë sesioneve të veçanta të punës, ku në agjendë përfshihen sesione që trajtojnë çështje edhe më të përgjithshme nga folësit ndërkombëtarë dhe persona që merren me çështje të caktuara.

Trajnimet në tema më të veçanta mbuloohen në bashkëpunim me organizatat partnere, për shembull, një varg trajnimesh për të drejtën autoriale dhe të licensimit janë mbajtur nga CELIP në dhjetra vende anëtare të eIFL.

eIFL e ka hartuar programin e saj të trajnimeve në të dhënit e informacioneve bazë të ndërtimit të konsorciumeve të bibliotekave. Plane të tjera përfshijnë trajnime në menaxhimin e konsorciumeve të bibliotekave; integrimin dhe menaxhimin e burimeve elektronike; shfrytëzimin e statistikave; negocimin me agjentët e shitjes; marketingun dhe promovimin e shërbimeve të konsorciumeve.

Shfrytëzimi i përbashkët i dijes dhe i informacionit

Informacionet e ofruara nga koordinatoret e eIFL –it, kanë treguar se eIFL e ka ushqyer një shpirt frymëzues të një komuniteti i cili përforcon shërbimet e përbashkëta dhe merr iniciativa me vlerë edukative. Duke qenë pjesë e një grupi rajonal dhe duke marrë shembuj nga fqinjët, paraqet një ndihmesë të madhe për koordinatoret në kryerjen e detyrave të tyre të përditshme lidhur me promovimin, gjetjen e fondeve për blerjen e burimeve elektronike dhe vlerësimin e tyre.

eIFL e promovon shfrytëzimin e përbashkët të dijes dhe të informacionit nëpërmjet një sërë aktivitete:

- Asambleja së përgjithshme, e organizuar nga eIFL për çdo vjet u ofron koordinorëve të vendeve të eIFL mundësinë që të takohen me njëri-tjetrin si dhe me përfaqësuesit e komunitetit të botuesve për t'i diskutuar çështjet dhe problemet e zakonshme.
- Disa *listservs* dhe grupe për diskutime – sipas llojit të përfshirjes dhe sipas rajonit gjeografik – funksionojnë nga eIFL.net për nivele të ndryshme të bashkëpunimit ndër koordinatoret kombëtarë.
- Faqja e internetit të eIFL, e cila është riorganizuar kohët e fundit, funksionon si një portë dhe ka për synim të shërbejë si një mjet dinamik i informacionit me anë të së cilës do të sigurohen lajmet, ngjarjet, dokumentet si dhe ndonjë material tjetër që ka të bëjë me eIFL.

Udhëzime

Ndër shërbimet e eIFL.net sigurohen po ashtu edhe udhëzime për t'i mbështetur koordinatoret e vendeve në aktivitetet e tyre lidhur me konsorciumin.

Më poshtë, janë disa udhëzime, ose do të vëhen së shpejti në dispozicion, në këtë adresë interneti:

Shembull:

Vendet e varfëra të botës do të pajisen me një mjet të ri kërkues.

Alfred Hermida, 15 korrik 2003














































<http://news.bbc.co.uk/go/pr/fr/-/2/hi/technology/3065063.stm>














































Ky është një tregim nga editori i lajmeve teknologjike në internet të BBC, i cili sqaron se si popullsia e vendeve të varfëra së shpejti do të ketë mundësi të shfrytëzimit të pasurisë së informacioneve në internet me një metodë të re dhe të lirë.

- Udhëzime për udhëheqjen efektive të grupeve në fokus: lexo këto udhëzime në pjesën e dedikuar vetëm për anëtarë në: http://www.eifl.net/members/members_knowledge.html#report
- Udhëzime për bibliotekarët, se si të negociohet për blerjen e burimeve elektronike: lexo këto udhëzime në pjesën e dedikuar vetëm për anëtarë në: http://www.eifl.net/members/members_knowledge.html#raport
- Analizimi i koleksioneve, menaxhimi i burimeve elektronike dhe integrimi i burimeve elektronike: udhëzimet mund të gjenden vetëm në pjesën e dedikuar për anëtarë në: http://www.eifl.net/members/members_knowledge.html#report
- Gjenerimi i të ardhurave dhe modeli i ndarjes së përbashkët të kostos për konsorciumet: një vështrim i përgjithshëm për ndarjen e përbashkët të modeleve të kostos dhe gjetja e një formule: lexo këto udhëzime në pjesën e dedikuar vetëm për anëtarë në: http://www.eifl.net/members/members_knowledge.html#report
- udhëzime dhe manualë për statistikat: lexo këto udhëzime në pjesën e dedikuar vetëm për anëtarë në: http://www.eifl.net/members/members_knowledge.htm.#report

Anëtarët e eIFL

Vendet në vijim janë aktualisht pjesë e rrjetit të eIFL. Nëse përfaqësoni ndonjë institucion dhe dëshironi t'i bashkangjiteni rrjetit të eIFL, kontaktoni me koordinatorët e vendit që i takoni.

Vendi	Coordinatori i vendit	Mail	Web
 Albania	Gjergj Turtulli	gturtulli@osfa.soros.ai 	
 Armenia	Anry Nersessyan	nerses@flib.sci.am 	
 Azerbaijan	Gulnara Gasimova Ajdar	gulnara9@yahoo.com 	
 Belarus	Petr Lapo	lapo@bsu.by 	
 Bosnia	Azamina Njuhovic	azamina@nub.ba 	
 Botswana	Dudzile Mbaakanyi	mbaakany@mopipi.ub.bw 	
 Bulgaria	Nadya Terzieva	nterzieva@nbu.bg 	
 Cambodia	Chheng Pharin	pharin@khmerstudies.org 	
 Croatia	Ivan Mihel	ivan.mihel@zg.tel.hr 	
 Czech Rep	Hana Nova	hana.nova@nkp.cz 	
 Estonia	Marika Meltsas	marika@utlib.ee 	
 Georgia	Irakli Garibashvili	igar@hotmail.com 	
 Guatemala	Marta Leticia Garcia	Mavassaux@soros.org.gt 	
 Kazakhstan	Olga Kvochkina	rntbb@nursat.kz 	
 Kosova	Shukrije Rama	shuki29@hotmail.com 	
 Kyrgyzstan	Elmira Shapovalova	bibl@it.kg 	
 Latvia	Gunta Luse	Linc@latnet.lv 	
 Lesotho	Matseliso Moshoeshoe Chadzingwa	m.moshoeshoe-chadzingwa@nul.ls 	
 Lithuania	Ausra Vaskeviciene	mauvask@irs.lt 	

 Macedonia	Ana Pejcinova	ana@kaleidoskop.org.mk 	
 Malawi	Steve Mwiyeriwa	smwiyeriwa@chirunga.sdnp.org.mw 	
 Moldova	Silvia Ghinculova	gsilvia@lib.ase.md 	
 Mongolia	Ariunaa Lkhagvasuren	lariunaa@soros.org.mn 	
 Montenegro	Nikoleta Kovacevic	nikols@cg.yu 	
 Namibia	Johan Loubser	jloubser@mec.gov.na 	
 Nigeria	Abdulsalami Rilwanu	rilwanu@hotmail.com 	
 Peru	Carolina Trivelli	Trivelli@IEP.org.pe 	
 Poland	Jan Andrzej Nikisch	nikisch@pfsi.poznan.pl 	
 Russia	Alexander Kuznetsov	kouz@osi.ru 	
 Serbia	Biljana Kosanovic	biljana@nbs.bg.ac.yu 	
 Slovakia	Maria Kollarová	kollarova@snk.sk 	
 Slovenia	Karmen Stular	karmen.stular@nuk.uni-lj.si 	
 South Africa	Hannie Sander	js@bib.rau.ac.za 	
 Swaziland	Zipho Ngcobo	zngcobo@uniswacc.uniswa.sz 	
 Tajikistan	Tatiana Kiseleva	alex@gerbl.tajik.net 	
 Ukraine	Oleg Segin	segin@irf.kiev.ua 	
 Uzbekistan	Marat Rakhmatullaev	Marat@osi.uz 	
 Zambia	Hudwell Mwacalimba	HMwacalimba@library.unza.zm 